



Ç'ËSHTË

FEJESA

SIPAS

SHERIATIT?

Fejesë quhet shfaqja e dëshirës së burrit për t'u martuar me një grua të caktuar, duke lajmëruar kujdestarin e gruas për këtë.

ZGJEDHJA E BASHKËSHORTËVE

a. Zgjedhja e bashkëshortes

1. Të jetë e përkushtuar ndaj fesë

Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, Muhamedi, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: *"Gruaja martohet për shkak të katër gjërave: për shkak të pasurisë, të prejardhjes, të bukurisë dhe për shkak të fesë. Merre atë që ka fenë, të lumshin duart!"*¹

2. Të jetë e pajisur me cilësitë e përmendura në hadithin vijues

*"Gruaja më e mirë është ajo që kur e shikon të gëzon, kur e urdhëron të bindet, kur të betohesh lidhur me të nuk të zhgënjën dhe kur ti mungon ajo e ruan veten dhe ta ruan pasurinë."*²

3. Të jetë e bukur

Prej cilësive që pëlqehet t'i ketë gruaja, veçanërisht në kohën tonë, është bukuria, ngase pranë saj do të gjejë më shumë qetësi shpirtërore, do ta ruaj shikimin e vet dhe do ta dojë më shumë. Kjo kuptohet nga thënia e të Dërguarit të Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, e përmendur në hadithin paraprak *"gruaja më e mirë është ajo që kur e shikon të gëzon..."*, sepse po të mos ishte e bukur nuk do ta gëzonte burrin e saj kur ai e shikon atë.

4. Pëlqehet të jetë beqare

Xhabiri, radijAllahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, i ka

thënë: *“O Xhabir, u martove me beqare apo me vejushë?”* Ai i kishte thënë: *“Me vejushë”. Atëherë, i Dërguari, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, i kishte thënë: “Po përse nuk more ndonjë beqare që ta argëtohet e edhe ajo të të argëtojë?”*³

Nganjëherë mund të ndodhë që gruaja e ve të jetë më e përshtatshme për burrin, siç është rasti me Xhabirin, i cili kishte nën përkujdesje shumë motra të vogla, andaj dëshironte të martohej me një vejushë që të kujdesej ajo për motrat e tija.

5. Të jetë e dashur për burrin dhe të jetë pjellore⁴

Ma'ëkil ibën Jesari, radijAllahu anhu, thoshte: *“Një njeri erdhi te Pejgamberi, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, dhe i tha: “E kam gjetur një grua me prejardhje të mirë dhe të bukur, mirëpo nuk lind. A të martohem me të?” I tha: “Jo.” Ai i erdhi për të dytën herë, por sërish e ndaloi. Kur i shkoi për të tretën herë, i Dërguari, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, tha: “Martohuni me ato gra që lindin shumë dhe që janë të dashura, sepse unë do të mburrem me numrin tuaj para popujve të tjerë.”*⁵

6. Të jetë nga ndonjë mjedis fisnik

I Dërguari i Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, thoshte: *“Njerëzit i ngjajnë mineraleve, ata janë sikurse mineralet e arit dhe të argjendit, më të mirët prej jush në kohën e xhahilijetit (në kohën paraislame) janë më të mirët në Islam, në qoftë se udhëzohen.”*⁶

b. Zgjedhja e bashkëshortit

I Dërguari i Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, thoshte: *“Nëse ju vjen ndokush, me fenë dhe moralin e të cilit jeni të kënaqur martoheni. Po qe se nuk veproni kështu, atëherë do të ndodhin sprova në tokë dhe shkatërrime të mëdha.”*⁷

Gjatë zgjedhjes së bashkëshortit duhet t'i kushtohet rëndësi çështjeve në vijim:

1. Të jetë i përkushtuar ndaj fesë dhe i moralshëm, duke u bazuar në hadithin e sipërpërmendur.
2. Të jetë nga një mjedis fisnik, duke u bazuar në hadithin *“Njerëzit i ngjajnë mineraleve...”* i cili u përmend më parë.
3. Të mos jetë steril, duke u bazuar në hadithin *“unë do të mburrem me ju para popujve të tjerë”*.
4. Të ketë mundësi ta furnizojë gruan me ushqim, veshmbathje dhe t'i sigurojë strehim, sepse kjo gjë është e kërkuar që të mund të vazhdojë bashkëjetesa. Kur Fatimeja, e bija e Kajsit e pyeti të Dërguarin e Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, që të martohet me Muavijën, i Dërguari, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, i tha: *“Muavija është shumë i varfër, nuk ka pasuri.”*⁸

RREGULLA QË KANË TË BËJNË ME FEJESËN

1. Nëse një burrë ka kërkuar dorën e ndonjë vajzë dhe nuk është refuzuar, atëherë nuk i lejohet

askujt tjetër ta kërkojë dorën e asaj vajze, sepse i Dërguari i Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: “Të mos e kërkojë asnjëri prej jush dorën e ndonjë vajze po qe se është duke e kërkuar dorën e saj vëllai i vet (nga feja), derisa të heq dorë i pari ose t’ia lejojë.”⁹

2. Në qoftë se ndokush pyetet për ndokënd për qëllim martese, atëherë ai duhet t’i tregojë çdo gjë që di për atë dhe kjo nuk është përgojim, por është gjë e kërkuar fetarisht.

3. Duhet ditur se në qoftë se arrihet pajtimi për fejesë, atëherë ky është vetëm premtim për martesë dhe këta të fejuar janë të huaj për njëri-tjetrin derisa të lidhin kontratën e martesës.

SHIKIMI I TË FEJUARËS

Nëse një mashkull dëshiron të martohet me ndonjë femër, atëherë është e ligjshme për të, madje është sunet që ai ta shohë vajzën me të cilën dëshiron të martohet. Për këtë dëshmon hadithi që e përcjell Sehël ibën Sa’di, radijAllahu anhu, se një grua erdhi te i Dërguari i Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, dhe tha: “O i Dërguar i Allahut, erdha të ta dhuroj veten time.” Atëherë, i Dërguari i Allahut e shikoi atë duke e soditur mirë, pastaj e largoi shikimin nga ajo.¹⁰ Këtë gjë e dëshmon edhe hadithi i Xhabirit, i cili thotë: I Dërguari i Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, thoshte: “*Kur ndokush fejohe me ndonjë vajzë, nëse ka mundësi të shohë tek ajo diçka që e shtyn atë të martohet me të, le ta bëjë.*” Pastaj, Xhabiri, radijAllahu anhu, tha: “Kur u fejova me një grua, fshihesha për ta parë atë, derisa pashë tek ajo diçka që më shtyri të martohesha me të, kështu që u martova me të.”¹¹

Atij i lejohet t’i shoh ato pjesë të femrës që duken zakonisht, siç janë fytyra, duart, këmbët, qafa dhe flokët.

Gjithashtu, edhe vajzës i lejohet ta shohë burrin me të cilën dëshiron të martohet.

Urtësia e tërë kësaj është që të zgjasë sa më shumë dashuria dhe harmonia mes bashkëshortëve, siç i tha i Dërguari i Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, Mugires, i cili ishte fejuar me një grua: “*Shihe atë, sepse kjo, pa dyshim, është më e sigurt për jetëgjatësinë e lidhjes suaj.*”

Vini re: Shikimi me epsh lejohet vetëm ndërmjet burrit dhe gruas së vet dhe ndërmjet robërshës dhe zotërisë së saj.

Përgatiti: Jusuf Kastrati – Shembulli.com

1. Buhariu (5090), Muslimi (1466).

2. Nesaiu (6/68), Ahmedi (2/251), Bejhakui (7/82), Tajalisiu (1/306).

3. Buhariu (5079), (5247), Muslimi (715).

4. Kjo gjë mund të kuptohet nëse shikohet shëndeti fizik i saj dhe nëse shikohen të afërmet e saj, siç janë motrat, hallat dhe tezet.

5. Ebu Davudi (2050), Nesaiu (3227).
6. Buhariu (3353), Muslimi (2526).
7. Tirmidhiu (1084), Ibën Maxhe (1967), Taberaniu (1/141), kurse Albani e ka vlerësuar si “hasen” në librin “Et-tergijb” (3090).
8. Muslimi (1480).
9. Buhariu (5142), Muslimi (1412).
10. Buhariu (5087), Muslimi (1425).
11. Ebu Davudi (2082), Ahmedi (3/334), kurse Albani e vlerësoi si “sahih” në “Es-silsile es-sahiha” nr. (99).